



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË ,KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Fier**

Nr 257 / Prot

Fier më, 07 .08.2025

Lënda: Njoftim për Vend te lire pune .

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit Nr 759 datë 30.09.2024 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarisë menaxhimit te burimeve ,përberës së njesisë së zhvillimit të institucioneve ,ofruesve te arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhdueshem profesional të personelit ”.

Ofruesi i AFP_së, Qendra e Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton Vend te lire pune për pozicionin:

Pergjegjes I Sektorit te Administrimit te Formimit Profesional Publik Fier :

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a)Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b)Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryejë detyrën
- c)Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d)Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e)Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f)Të demostroj aftësi te punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a)Të ketë diplome te studimeve universitare te nivelit “Master shkencor ” (ose te barazvlefshme)ne nje nga fushat qe lidhen me kualifikimet profesionale ne lidhje me ofrusit publik te AFP-se .
- b)Të kete të paktën 3(vjet) përvojë pune në nje ofrues publik te AFP –së .

c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit .

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë , duhet të përfshijë.

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në)

c) kartën e indentitetit

d) diplomë/deftese e shkollës së mesme

e) librezë e punës

f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim CV;

g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) vërtetimin i gjëndjes shëndetësore

i) vërtetimin e gjëndjes gjyqësore

j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre ; Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofrimit të AFP-së brenda datës. 15.08.2025

DREJTORI

Aleksander Lalaj

